



| | | | |
|---|------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|
| Planuar / Ditur / Planned / Predicted / Planned / Predicted | 18.01.2022 | 2 | viti / year |
| Organ / Agjencia / Org / Unit | Dr. Prof. Dr. Prof. | Shtetë / Princ / Appoint | Sheria / Kategoria / Quantity |
| SKIMSHICK | 210/2022 | | 1/2 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1205/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1453/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.161/2020 të datës 16.06.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim nën 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nën 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.161/2020 të datës 16.06.2020 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 21.05.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 05.06.2020 ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 21.05.2020. të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit.

Ankuesi kundër vendimit të datës 21.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit me datë 16.06.2020 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër protokoll 1166/2020, me pretendimet ankimore për ngritjen e ngritje e koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7) dhe kompensimit retroaktiv për një (1) koeficient sipas akt emërimit me numër Nr:01-112-54804 prej datës 16.09.2016 deri në ditën e parashtrimit të ankesës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1166/2020 e datës 16.06.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 21.02.2020; Akt emërimi i datës 18.09.2015; Akt emërimi i datës 16.09.2016; Lista e pagave për muajin janar të vitit 2020; Kërkesa e datës 24.04.2020; Ankesa e ankuesit e datës



21.05.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; vendimi i datës 05.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Procesverballi i datës 21.05.2020; Kërkesa finale për ndarjen e mjeteve për financim të projekteve për vitet 2020-2022 e datës 16.08.2019; Kërkesa për ndarjen e mjeteve për financim të projekteve për vitet 200-2022 e datës 19.09.2019; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.07.2020; konkursi i datës 10.07.2015; Lista e pagave për muajin tetor të vitit 2015 si dhe për muajin tetor të vitit 2016; Vendimi numër A.nr.523/2018 i Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil të Kosovës i datës 04.10.2018; Njoftimin e datës 30.07.2020; Aktgjykimin A.nr.1453/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 16.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës të ankuesit, me datë 04.10.2018 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.523/2018, me të cilin ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit kështu që Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës 16.06.2020 të ankuesit është bërë i pamundur siç përcaktohet me dispozitat e nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”*, pasi që për rastin e ankuesit është vendosur njëherë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1205/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Drenasit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit;
- Znj. Lirije Maksutaj, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Arkivit të KPMSHCK-së